



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail: contact@pallatirinise.com

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në Rregulloren Nr. 1/1373 të datës 22.11.2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a dhe Plotësim ndryshimi i Rregullorës Nr.1/2017 të datës 28.10.2025 dhe Rregulloren për Marrëdhënien e Punës me Nr. 1/1338 data:14.11.2024 në N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a, si dhe të Statutit të N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L Pallati i Rinise Sh.a. – Prishtinë, me datë: 12.08.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **ANULOHEN** konkurset publike për pozitat "Arkatar/e dhe Ndhmës/e Administrativ/e nga një (1) pozitë pune.
3. **Obligohet** Zyra e Burimeve Njerëzore në zbatim të këtij vendimi të bëjë njoftimin publik për anulim të konkursit përfshirë edhe njoftimin e palëve eventuale të përfshira.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

N.P.L. "Pallati i Rinisë" Sh.a., më datë 10.07.2026, ka shpallur konkurs publik me nr. 1/1552 dhe 1/1546 për plotësimin e pozitive të punës "Arkatar/e" dhe "Ndhmës/e Administrativ/e" nga një (1) pozitë pune, me afat aplikimi deri më datë 24.07.2026.

Pas përfundimit të afatit të aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, është bërë verifikimi i përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në konkursin publik, përkatësisht të kërkesave lidhur me kualifikimin arsimor, përvojën e punës dhe dokumentacionin tjetër të kërkuar.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të kandidatëve rezulton se **asnjë nga kandidatët e aplikuar nuk i ka përmbushur në tërësi kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkursin publik për pozitat përkatëse.**

Për këtë arsye, duke pasur parasysh se procedura e rekrutimit mund të zhvillohet vetëm me kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me

konkursin publik dhe me qëllim të respektimit të parimeve të ligjshmërisë, transparencës, meritës dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve, është vlerësuar se nuk ekzistojnë kushtet për vazhdimin e procedurës së rekrutimit.

Rrjedhimisht, **anulimi i konkursit publik është i nevojshëm për shkak se asnjë kandidat nuk i ka përmbushur kriteret dhe kushtet e përcaktuara në konkursin publik**, dhe për këtë arsye procedura nuk mund të vazhdojë deri në përzgjedhjen e një kandidati i cili nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara.

Bazuar në sa më sipër, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla juridike :Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në Komisionin e Ankesave, në afat prej 7 ditëve , nga dita e pranimit të vendimit.

Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L Pallati i Rinisë Sh.A.-Prishtinë

Shpend Bilalli

Vendimi u dërgohet:

- Arkivit të N.P.L Pallati i Rinisë Sh.a;
- Zyrës së Burimeve Njerëzore;
- Anëtarëve të Komisionit Vlerësues